**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

Nr. 5490/1 Prot. Pogradec, më 06. 12. 2021

# VENDIM

## NR. 103, DATË 02.12.2021

## MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 02.12.2021 TË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme,pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 02.12.2021, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

**KËSHILLI I BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 02.12.2021 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Sotiraq MANGËRI**

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 02.12. 2021**

ORA : 12 : 00

JANË PRËZËNT 20 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLËDHJËS SË KËSHILLIT BASHKIAK TË DATËS 02.12.2021, MË KËTË RËND DITË.

RËNDI I DITËS

1. **Projekt – vendim:** Për miratimin e kërkesës së familjes së z.Ervehe Brahimllari që do të vazhdojë procedurën e privatizimit të banesës shtetërore që ka mbetur pa privatizuar.
2. **Projekt – vendim:** Për Miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave publike" dhe "Harta që përcakton rrugët e qytetit ,të cilat përjashtohen nga kjo rregullore"
3. **Projekt – vendim:** Llojet dhe nivelet e gjobave në rastet e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative në Bashkinë Pogradec"
4. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec për vitin 2022"
5. **Projekt – vendim:**Për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor public, të sipërfaqes pyjore prej 37.93(tridhjete e shtatë presje nëntëdhjetë e tre)Ha në Ekonominë Pyjore Mokër 2 , për shfrytëzimin me karrierë të mineralit hekur-nikel, në zonën minerare "Bari I Bardhë"( Debrovë), nga shoqëria "Joal shpk".
6. **Projekt – vendim:**Për themelimin e shoqërisë "Qëndra Multifunksionale Pogradec " sh.a dhe miratimin e aktit të themelimit.
7. **Projekt – vendim:**Për miratimin e statutit të shoqërisë "Qëndra Multifunksionale Pogradec" sh.a

z. S. Mangani : Mirëdita të gjithëve!
Takimi i sotëm është takim jashtë radhe, sepse mbledhja ishte planifikuar për më vonë.
Falënderoj Bashkin e Pogradecit për organizimin e festave të larmishme në kuadër të festave të nëntorit.
Mbledhjen e deklaroj të hapur.
Ftoj këshilltarët të hedhim në votim rendin e ditës.

**Hidhet në Votim Rëndi i Ditws**

PRO 20

KUNDËR 0

ABSTËNIM 0

Miratohet rendi i ditës me 20 vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më ___.___. 2021**

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.

z. S. Manporei.
Pika nr. 1 e Rendit të ditës është miratimi i rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
Ftoj Këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 1 të rendit të ditës, për miratimin e Rendit të ditës së Mbledhjes.

**U votua**

**Pro** 20

**Kundër** 0

**Abstënim** 0

**Miratohet** **Po** (rrethuar) **Jo**

Miratohet pika nr. 1 e rendit të ditës me 20 vota pro

**2.Projekt – vendim:** Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 18.11.2021 të Këshillit Bashkiak Pogradec

Z. S. Mançelli

Projekt – vendimi nr. 2 është miratimi i Procesve-rbalit të mbledhjes së datës 18.11.2021 të Këshillit Bashkiak Pogradec.

Jeni njohur me procesverbalin e mbledhjes së datës 18.11.2021.

Ftoj këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 2. të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 20

**Kundër** 0

**Abstënim** 0

**Miratohet** **Po** (rrethuar) **Jo**

Miratohet pika nr. 2 e rendit të ditës me 20 vota pro.

**3.Projekt – vendim:** Për miratimin e kërkesës së familjes së z.Ervehe Brahimllari që do të vazhdojë procedurën e privatizimit të banesës shtetërore që ka mbetur pa privatizuar.

z. S. Magjari: projekt -vendimi nr. 3 është për miratimin e kërkesës së familjes së z. Ervehe Brahimllari që do të vazhdoj procedurat e privatizimit të banesës shtetërore, që ka mbetur pa privatizuar.
Dokumentacioni është i plotë, andaj ftoj këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 3 të rendit të ditës.

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstënim 0

Miratohet pika nr. 3 e rendit të ditës me 20vota pro.

**Miratohet** (Po) Jo

4.Për Miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave publike" dhe "Harta që përcakton rrugët e qytetit ,të cilat përjashtohen nga kjo rregullore"

Z. S. Manperi: Ftoj drejtoreshën e tatim-taksave (Znj. Enjela) për më shumë detaje rreth pikës nr. 4 të rendit të ditës.

Znj. Enjela: Kemi hartuar një rregullore për shfrytëzimin e hapësirave publike dhe hartën për përcaktimin rrugët e përfshira, të cilat përjashtohen nga kjo rregullore.

Në këtë rregullore përcaktohet se si subjektet do të trajtojnë në Bashkinë e Pogradecit, procedurat e aplikimit për tu pajisur me lejë të cilat duhen të kenë patjetër.

Hapësirat më pak se 2,5 m trotuar nuk do të përdoren.

Është menduar të shfrytëzohet trotuari tek rruga: "10 Korrikmorët e Pojskës".

E gjithë pjesa e lulishtes do përdoret vetëm për subjektet që punojnë aty.

Sheshin e lojërave për fëmijë kemi menduar ta vendosim në dy vende / 1. në sheshin pranë lokal Eros dhe 2. tek pranë Turizmit të Vjetër.

Përjashtohen nga kjo rregullore:

- tregu ambulant
- sheshi tek Bashkia ku kemi disa subjekte që operojnë si: Bar Lipeni, Dante, sepse trotuari është 2.5 m dhe këto subjekte do të vazhdojnë të kryejnë aktivitetin specifike është pjesa e vazhduar, të cilat do të pajisen me logo, deri në pesë logo të njëjta.

Nga janari i vitit 2022 të gjitha subjektet do të bëjnë kërkesën për shfrytëzimin e hapësirave publike, ku përjashtohen vetëm tregtimet e materialeve plastike.

Bar Kafet, Restorantet me tavolina, pulte-perimet do të jenë tek vendet e vendosura nga Bashkia Pogradec.

**U votua** S. Manperi. Hedhim në votim pikën nr. 4 të rendit të ditës me një ndryshim, ku do të hiqet emërtimi "visit Pogradec" dhe do vendoset ~~[illegible]~~ me emërtimi "Përshëndetje"

**Pro** 20

**Kundër** 0

**Abstënim** 0

**Miratohet** (Po) Jo

Miratohet pika nr. 4 e rendit të ditës me 20 vota pro.

**5.Projekt – vendim: :** Llojet dhe nivelet e gjobave në rastet e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative në Bashkinë Pogradec

Z.S. Manperi: Ftojmë drejtoreshën e tatim-taksave të na flasi më tepër për pikën nr. 5.
Znj. Enjela
Për një njoftimi të parë, po jeu vë në dijeni për
disa gjoba do të jenë më të larta, në mënyrë për
të kenë efikasitet në
përe zënie të hapësirës publike, nga 200 dyqind lekë
do të behet 2000 dy mijë lekë
S. Manperi: një gjobë duhet të aplikohet edhe
për familjet që ndotin mjedisin duke i hedhur
mbeturinat jashtë kazanave të plehrave
Një lloj gjobe tjetër duhet të jetë edhe për
vendosjen e tabelave dhe panakotave, sigurisht
më parë duhet të mendosojmë një kënd
ku mund të perdorin këto njoftime nga
subjekte të ndryshme
Enjela → këto projekt-vendime kositojnë pikërisht
në këto.
Znj. Blacari. Për vitin 2020 sa gjoba u janë
vendosur individëve?
Përgjegjësi i policisë Bashkiake: është pak e vështirë
të vendosësh gjoba individëve sepse është e vështirë
vjelja e tyre.
Z. Mollo: mendoj për gjobat ku vend në shtëpi dhe të
mos u afrohen shërbime pa paguar gjoban.
Z. Dhurata: vetëm se pyetësorët duhen të informohen.
Znj. Enjela: për informimin e pyetësorëve do të
themi. Hojmë një emision në tv, kot 7, si dhe do të
përdorim faqen zyrtare të Bashkisë në Pogradecit.
Z.S. Manperi: Ftoj këshilltarët të hedhim në votim
pikën nr. 5 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 20

**Kundër** ______

**Abstënim** ______

**Miratohet** **Po** (circled) **Jo**

Miratohet pika nr. 5 e rendit të ditës me 20 vota pro.

**6.Projekt – vendim: :** "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec për vitin 2022"

S. Manperi: Vazhdojmë me pikën nr. 6 të rendit të ditës. Ftoj drejtoreshën e taksave.
Enjola =>
Viti 2022 do të fillojë me lehtësimet.
Do të përjashtohen nga tarifa e gjelbërimit – OJF-të.
– bizneset me më pak se 25 punëtorë
– pronarët nën moshën 25 vjeçare
Për grupet kryefamiljare do të ketë 20% ulje nga kjo taksë
Për familjet me ndihmë ekonomike dhe pensionistët që jetojnë vetëm do të kenë 30% ulje
Për gratë që nuk janë në marrëdhënie pune dhe janë kryefamiljare pagesa për taksën e gjelbërimit është 0.
Janë 12 000 dymbëdhjetë mijë pensionist që jetojnë vetëm dhe që do të paguajnë më pak.
Tek tarifa e ndërtesave kemi një rritje prej 4 lekësh
Tarifa e pastrimit për familjet që nuk jetojnë këtu do të paguhet e plotë, ndërsa (?) ato familje vinë në pikun e ndotjes.
E re për tarifat e pastrimit janë familjet që kanë shtëpi me oborr që mbushin koshin e mbeturinave me mbetjet e oborrit, do të paguajë 25% më shumë kur kanë deri në 100 m oborr dhe mbi 100 m 50% më shumë
Për bizneset do të ketë rritje 20% për tarifën e pastrimit duke i ndarë në kategori.
Tek familjet tarifa e gjelbërimit do të jetë e njëjtë.
Tarifa e ndriçimit, 1500 lekë për njësitë Buçimas, Çërravë dhe fshatrat ndërsa për të tjerat 1200 lekë.

**U votua** Kampohet. A. Laska
Exjon. Shkullaku

**Pro** 17

**Kundër** ________

**Abstënim** 1 M. Shuli

**Miratohet** (**Po**) **Jo**

17 vota Pro.

Miratohet pika nr. 6 e rendit të ditës me 17 vota pro.

Për bizneset nga 2000 në 3000 tre mijë lekë
Në vitin 2022 lulishtja që do të shfrytëzohet do të paguhet duke u llogaritur me m², 1000 (një mijë) lekë në muaj m²
Për bizneset pranë Bulevardit, Bar Lipeni, Europa 500 pesëqind lekë m².
zona tek vilat 300 lekë m²
Zonat e tjera 400 lekë m².
Shezllonat do të paguhen me m².
Doskat – janë 14 doska që do të vendosen tek zona e lejuar për tregtarët ambulant, me një pagesë 200,000 të vjetra në sezon, dhe 100,000 të vjetra në periudhën e dimrit.
Tek pagesa e vetëlave kemi një rritje 200 lekë për cop. në ditë,
Mjetet motorike 500 lekë në ditë.
Lodrat për fëmijë: pjesa tek dega 250 lekë m², tek Tunzimi i Vjetër 150 lekë m².
Tek tarifat për shërbimet, vërtetimi i banimit do të jepet pa pagesë.
Për subjektet që janë në pronën e tyre do të paguajnë 50,000 lejen.
Për të marrë me qera Odeonin, kinemanë kemi vendosur disa tarifa.
Celnik Hoxhilleri .. Projekti Buxheti ka dy anë, njëra anë janë pagat, shpenzimet, dhe ana tjetër janë transfertat specifike, ndaj plani i taksave do të jetë ky.
Loreta – Unë e kundërshtoj rritjen e taksave 20% për bare-restorantet, sepse jemi në një kohë pandemie.
Enjela – Secili duhet të paguaj për dëmin që shkakton. Banjat p.sh. niveli i ndotjeve të tyre është maksimalisht i ulët, ndaj nuk mund të paguajnë njësoj me bare-restorantet.
Bashkia ka vendosur të ulë një taksë që të arrijë të paguaj firmat e pastrimit.
S. Mangeri: Ne bëmë një mbledhje vetëm për bizneset, dhe pronarët e tyre nuk u paraqitën.
H. Blacai: Falënderoj drejtoreshën, Enjelën për nismat e marra dhe për argumentimin e plotë të tyre.
Shumë e rëndësishme është mbështetja që u është dhënë grave artizane, grave në nevojë dhe pensionistëve.

S. Mançerei. Jemi tek lejimi i lejeve për hapsirat e lulishteve. Unë mendoj që duhet të paguhet më tepër gjatë sezonit korrik-gusht përkatësisht, dhe më pak për muajt e tjerë.

B. Mobrorei : E përshëndes drejtoreshën dhe i besoj këtij projekti, por mendoj që rritje 5 milionësh duhet të ketë edhe ushqimet në restorante.

Enjela. Nuk mund të barazohet çmimi i lulishteve, me çmimin e hapsirave të tjera.

M. Kamolli. Sa i rritën në total taksat në vit një pyetësori?

Enjela. Në Pogradec, njësin administrative Buçimas dhe Çërravë 500, lekë; (pesqind lekë), ndërsa në njësit e tjera administrative 300 lekë (treqind lekë)
Për bizneset 2300 (dy mijë e treqind) lekë.

S. Mançerei. Të diskutojmë ankesën e prindërve tek kopshti "Liri Somo" për të paguar edhe kur fëmija nuk frekuenton.
Unë mendoj që kjo nuk është logjike.

Bedri Mobrorei. Unë mendoj që si fillim kopshti të rrisë standardet.

Selnikeu. Ky ndryshim duhet të bëhet mendoj, sepse ka fëmijë që janë të regjistruar dhe frekuentojnë shumë rrallë, ndërkohë që i zë vëndin një fëmije tjetër që mund të frekuentonte çdo ditë.

S. Mançerei. E hedhim në votim sygjerimin për tarifën e kopshtit "Liri Somo" që tarifa të mos ndryshojë, por të vazhdojë të jetë me kuotë ditore

Pro 16

Kundër 2 → Selnik Hoxhillari M. Kamolli

Abstenim 0

S. Mançerei : ~~[illegible]~~. Pra shumica e Këshilltarëve janë dakort që kjo tarifë të mos bëhet mujore por të qëndrojë siç ishte, ditore.

S. Mançerei. E hedhim në votim ~~[illegible]~~ sygjerimin për rritjen e taksave për Bar-restorantet. Jo vetëm muajin Korrik-Gusht, ~~të mos ndryshojë~~ por fikse gjithë vitin

Pro ~~[illegible]~~ 17

Kundër 1 Mimoza Shuli

Abstenim 0

S. Mançerei : ~~[illegible]~~ shumica e Këshilltarëve janë dakort që të mos ~~[illegible]~~ ndryshojë por të jetë fikse tarifa e vitin çdo muaj

S. Mançerei : Hedhim në votim projekt-vendimin nr. 6 "për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec për vitin 2022".

Miratohet pika nr. 6 me 17 vota pro. dhe 1 Kundër

7. **Projekt – vendim:** Për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor public, të sipërfaqes pyjore prej 37.93(tridhjete e shtatë presje nëntëdhjetë e tre)Ha në Ekonominë Pyjore Mokër 2 , për shfrytëzimin me karrierë të mineralit hekur-nikel, në zonën minerare "Bari I Bardhë"( Debrovë), nga shoqëria "Joal shpk".

S. Mangeri: Vazhdojmë me projekt-vendimin nr. 7 të rendit të ditës, i cili u rrëzua herën e kaluar, por ne na përkohet dokumentacioni sepse të ardhur nga Ministria përkatëse.
Edlira: Unë jam dakord që procedurat të vazhdojnë, por po përmendur emrin e subjektit.
B. Mokrani: Jam dakord për më kushtet që firma që do të operojë në atë zonë, të bëjë edhe rrugën, kjo më bërë të një kontrate.
Enardi: Në kontrat janë parashikuar rrugët që të rregullohen nga firma, por puna që i bëjnë ato është shumë e dobët.
Enjela: Kjo pikë nuk është në kontrat e parashikuar. Kjo mund të verihet në bërë të një marrëveshje.
Beqi: Emri i subjektit që operon nuk mund të hipet sepse ai ka një kontrat dhe një licencë nga ministria, prandaj ana ligjore është i detyrueshëm emri i subjektit.
Gjithashtu modeli i projekt-vendimit që na është përcaktuar nga ministria është me emrin e subjektit.
S. Mangeri: E hedhim në votim pikën nr. 7 të rendit të ditës.

**U votua**

Pro 16

Kundër 0

Abstënim 2. Edlira Dervishi, Manjola Kamolli.

**Miratohet** (**Po**) **Jo**

Miratohet pika nr. 7 e rendit të ditës me 16 pro

8. Për themelimin e shoqërisë "Qëndra Multifunksionale Pogradec " sh.a dhe miratimin e aktit të themelimit.

S. Mangoni: Vazhdojmë me pikën nr. 8 të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me themelimin e shoqërisë "Qëndra Multifunksionale Pogradec" sh.a dhe miratimin e aktit të themelimit.
Ftojmë përfaqësuesin e Bashkisë.
Beni:
Aksioneri i vetëm është Bashkia Pogradec, me 100% të aksioneve.
Shoqëria është e organizuar me një nivel, një administrator / këshilli i Administratorëve me tre anëtarë dhe Asambleja e Përgjithshme e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Pogradec.
S. Mangoni:
Ftoj këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 8 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** ~~16~~ 17 Largohet E. Dervishi

**Kundër** 0

**Abstënim** 0

**Miratohet** **Po** (rrethuar) **Jo**

Miratohet pika nr. 8 e rendit të ditës me ~~18~~ 17 vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradëc më ___.___. 2021**

**9.** Për miratimin e statutit të shoqërisë "Qëndra Multifunksionale Pogradec" sh.a

S. Mangari: Jemi tek pika nr. 9 e rendit të ditës, për miratimin e statusit të shoqërisë "Qendra Multifunksionale Pogradec" sh.a
Ftoj përfaqësuesin e Bashkisë Pogradec.
Besi:
Bëhet fjalë për miratimin e statusit të shoqërisë "Shoqëria Multifunksionale Pogradec" sh.a.
Është i njejti me projekt-vendimin nr. 8 që sapo u miratuar, por duhet e detyrueshme të miratohen veç e veç.
S. Mangari: Ftoj këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 9.

## U votua

**Pro** 18

**Kundër** ________

**Abstënim** ________

**Miratohet** **(Po)** **Jo**

Miratohet pika nr. 9 e rendit të ditës me 18 vota pro

Romeo Jaisar:

Përveç projekt-vendimeve të cilat i diskutuam dhe miratuam, kisha për të diskutuar rreth kërkesës të dërguar nga ana jonë në datë 29.09.2021 dhe për të cilën akoma nuk kemi marrë një përgjigje.

S. Marjeri: Ngarkoj sekretariatin e Koshillit Bashkiak Pogradec të merret me vijimin e procedurave të mëtejshme përsa i përket kërkesës suaj.

S. Marjeri: Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.